VENDIM
Nr. 6, datë 23.3. 2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"',

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 23–25.3.2022, si më poshtë:
- 227 lekë/litri për gazoilin;
- 208 lekë/litri për benzinën.
2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 23–25.3.2022, si më poshtë:
- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 218 lekë/litri për benzinën;
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.
3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"' .
4. Ky vendim për miratimin e çmimeve tavan, sipas pikave 1 dhe 2, i fillon efektet sot më datë 23.3.2022, ora 15:00.
5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,
Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi